


Tregtia e jashtme e mallrave

Qershor 2020

Tiranë, më 17 Korrik 2020: Në Qershor 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u ulur me 9,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 7,3 %, në krahasim me Maj 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u ulur me 2,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 16,1 %, në krahasim me Maj 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 29 mld lekë, duke u rritur me 3,6 %, krahasuar me Qershor 2019 dhe 24,1 %, në krahasim me Maj 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e Mallrave (%)




Në gjashtëmuajorin e parë 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 125 mld lekë, duke u ulur me 17,7 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 271 mld lekë, duke u ulur me 14,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 146 mld lekë, duke u ulur me 11,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 9,7 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: "Tekstile dhe këpucë" me -4,5 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -3,8 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me -1,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: "Ushqim, pije, duhan" me +1,7 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2020




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë ulur me 17,7 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -9,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,2 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 2,8 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,7 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +1,5 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2020



Si gjashtëmujor, importet janë ulur me 14,6 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2019. Grupet që kanë ndikuar neaktivisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndëdjegëse, energji elektrike” me -4,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -3,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Qershor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2019 janë: Kosova (4,1 %), Gjermania (2,3 %) dhe Maqedonia e Veriut (31,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-14,6 %), Greqia (-5,2 %) dhe Spanja (-35,7 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (14,0 %), Turqia (12,2 %) dhe Mbretëria e Bashkuar (14,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-24,6 %), Kosova (-28,1 %) dhe Spanja (-11,5 %).

Në muajin Qershor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2019 janë: Turqia (35,3 %), Kina (0,2 %) dhe Kosova (27,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,7 %), Greqia (-5,6 %) dhe Gjermania (-7,6 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Rusia (43,5 %), Mbretëria e Bashkuar (167,0 %) dhe Ukraina (61,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-20,2 %), Greqia (-10,7 %) dhe Turqia (-6,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2020



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 63,7 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,7 %), Greqia (7,7 %), Turqia (7,3 %) dhe Kina (6,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë 2020, me vendet e BE-së zënë 63,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Qershor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,0 %), Greqia (7,8 %), Gjermania (7,4 %) dhe Turqia (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	Janar - Qershor 18	158	18,4	310	4,7	-151	51,1
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	Janar - Qershor 19	152	-3,6	318	2,6	-165	48,0
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,7	52	-2,8	-29	44,5
	Janar - Qershor 20	125	-17,7	271	-14,6	-146	46,2

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan. - Qer. 2019	Jan. - Qer. 2020	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan. - Qer. 2019	Jan. - Qer. 2020
Vendet e BE-së	19.498	17.072	116.291	94.776	32.397	30.741	188.027	156.264
Austri	141	96	1.036	767	411	429	3.462	2.390
Gjermani	1.349	1.380	7.243	8.255	3.664	3.384	21.672	21.057
Greqi	1.146	1.087	6.442	5.697	4.960	4.681	28.279	25.256
Itali	12.549	10.720	75.723	57.097	14.811	13.817	82.672	65.997
Spanjë	1.643	1.056	9.529	8.438	1.080	794	5.745	4.321
Kroaci	138	173	600	931	634	716	3.371	2.834
Të tjerat e BE-së	2.533	2.560	15.718	13.591	6.837	6.920	42.827	34.409
Mbretëri e Bashkuar	43	91	373	427	540	430	2.644	7.060
Kinë	364	311	3.085	2.589	4.808	4.818	29.463	23.125
Kosovë	2.309	2.404	14.384	10.335	677	861	3.698	3.563
Maqedonia e Veriut	630	829	4.202	3.886	756	831	4.271	4.084
Rusi	-	0	70	6	835	853	5.554	7.969
SHBA	158	148	1.923	1.457	730	542	5.263	4.292
Turqi	99	250	981	1.100	3.863	5.225	26.809	25.011
Ukrainë	15	41	109	270	280	213	1.469	2.376
Zvicër	73	71	410	416	1.068	600	8.212	5.283
Të tjera	2.377	1.874	10.519	10.096	7.472	6.831	42.263	32.125
Gjithsej	25.565	23.091	152.348	125.358	53.426	51.946	317.674	271.150

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan.-Qer 2019	Jan.- Qer 2020	Qershor 2019	Qershor 2020	Jan. -Qer 2019	Jan.-Qer 2020
Gjithsej	25.565	23.091	152.348	125.358	53.426	51.946	317.674	271.150
Ushqime.pije.duhan	3.212	3.646	17.558	18.496	9.047	9.601	52.314	53.922
Minerale.lëndëdjegëse.en.el.	3.847	2.884	23.681	18.463	5.790	3.836	39.400	24.828
Produktekimikedheplastike	634	583	3.596	3.359	7.048	7.828	42.303	41.932
Lëkurëdheartikujtprejtyre	274	162	1.347	1.049	1.671	1.176	9.448	6.070
Prodhimedruridheletrë	778	646	4.721	3.944	2.259	1.806	12.102	10.807
Tekstiledhekëpucë	10.600	9.438	62.262	48.259	7.748	6.857	43.904	32.626
Materialëndërtimidhemetale	3.862	3.495	24.245	17.386	7.068	7.512	40.294	36.847
Makineri.pajsjedhepj. këmb.	1.516	1.540	10.390	10.628	10.680	11.181	66.223	54.354
Tëtjera	842	697	4.549	3.776	2.115	2.149	11.686	9.765

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	75.723	57.097	14.384	10.335	9.529	8.438	7.243	8.255
Ushqim.pijeduhan	4.037	4.147	1.887	1.899	694	587	651	738
Minerale. lëndëdjegëse. energjielektrike	3.109	581	3.452	1.539	7.566	7.184	653	509
Produktekimikedheplastike	965	918	968	991	15	73	34	31
Lëkurëdheartikujprejlëkure	1.087	882	4	3	131	71	7	10
Prodhimedruridheletrë	3.278	2.336	370	358	3	2	79	234
Tekstiledhekëpucë	48.627	35.580	45	60	1.006	428	3.822	4.682
Materialëndërtimidhemetale	7.397	5.839	6.501	4.333	109	73	851	666
Makineri.pajsjedhepjesëkëmbimi	5.204	5.240	354	340	5	7	759	978
Tëtjera	2.018	1.574	802	811	2	13	387	406

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Greqi		Turqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	82.672	65.997	28.279	25.256	26.809	25.011	29.463	23.125
Ushqim.pijeduhan	9.387	9.466	7.554	7.848	2.716	2.771	433	339
Minerale.lëndëdjegëse.energjielektrike	3.456	1.824	7.341	4.766	385	1.412	2	4
Produktekimikedheplastike	9.060	8.856	3.746	3.742	3.598	4.046	2.674	2.599
Lëkurëdheartikujprejlekure	7.565	4.972	17	13	117	92	390	228
Prodhimedruridheletre	3.375	2.781	1.594	1.626	1.475	1.323	509	379
Tekstiledhekëpucë	21.355	14.634	1.867	1.665	8.562	6.544	5.478	4.153
Materialendërtimidhemetale	9.892	8.099	4.038	3.572	5.503	4.594	5.033	3.136
Makineri.pajisjedhepjesëkëmbimi	16.031	13.283	1.316	1.337	3.398	3.402	12.227	10.043
Tëtjera	2.551	2.082	805	686	1.057	826	2.717	2.244

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri